KËRKESË
Nr. 223/4, datë 6.2.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 397, datë 13.5.2020, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore, loti III", i ndryshuar, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 8,522,574.60 (tetë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar (në vijim "ARRSH").

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

a) Për pasuritë e llojit "ndërtesë", është bërë bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, i ndryshuar, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit "ndërtesë banimi ose jo banimi", i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë ARRSH-së, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 8,522,574.60 (tetë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LINDORE, LOTI 3", I NDRYSHUAR, TIRANË

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË										SHËNIME
								Shpronësim tokë arë			Shpronësim tokë truall			Ndërtesë banimi (shtëpi)				
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m^2)	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. ndërt. konf. ZVRPP-së (m^2)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas ZVRPP-së (l/m^2)	Vlera (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	
1	NAIM	FERID	HOXHA	8170	10/243	TRUALL	140.7				140.7	32878	**4625934.6**	45.1	86400	**3896640**	**8,522,574.60**	**L. leg. me nr. 2623751, datë 28.2.2017, godinë banimi 1-katëshe, sip. e katit përdhes =38.2 m^2, sip. verande=6.9m^2.**
	Shuma												**4,625,934.60**			**3896640**	**8,522,574.60**	